



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:153166

Datë: 03.12.2024

Numri i dokumentit: 06539413

**C.nr.143/22**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH**  
**Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil**, si gjykatë civile e shkallë së pare, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M. S. dhe A. S., që të dy nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilet i përfaqëson sipas prokurës A. R., avokat nga Prizreni, Rr. "J. D. R.", nr..., Prizren, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, Aktash, Rr. "E. H." nr..., Prishtinë, lidhur me çështjen e kompensimit të demit, vlera e kontestit 5.000,00 €, jashtë seance, me datë 03.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I.** **Konstatohet** se padia e paditësve M. S. dhe A. S., që të dy nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilet i përfaqëson sipas prokurës A. R., avokat nga Prizreni, Rr. "J. D. R.", nr..., Prizren, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, Aktash, Rr. "E. H." nr..., Prishtinë, në këtë çështje juridiko - kontestimore, është e **TËRHEQUR**.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e saja procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. A. R. nga Prizreni kanë ushtruar padi në këtë gjykatë me bazë juridike kompensimi i demit kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, A., Rr. "E. H." nr..., Prishtinë.

Me datë 21.02.2024, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve av. A. R. nga Prizreni, përmes parashtrësës ka njoftuar gjykatën se paditësit e tërheqin padinë kundër të paditurës në lidhje me çështjen që është ngritur si objekt kontesti dhe këtë për faktin se në procedurë jashtëgjyqësore kemi negociuar marrëveshjen dhe kemi arritur marrëveshje dhe si të tillë e tërheqim padinë.

Në bazë të nenit 261 par. 1 të LPK-së është përcaktuar: "**Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pelqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi**", ndërsa në bazë të provave shkresore, gjykata konstaton se të paditurit deri më tani nuk i është dorëzuar aktvendimi për dhënjen e përgjigjës në padi.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Andaj, meqë palet sipas parimit të disponibilitetit e parapar me nenin 3.2 të LPK-së, lirish të mund të disponojnë me të drejtat e tyre, si dhe duke e aprovuar terheqjen e padisë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2022:153166, 03.12.2024**

**Gj y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa (neni 261.4 i LPK-së).